



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 3658 / Prot.
/ 3

Patos, më 11/11 / 2024

PROCESVERBALI I TAKIMIT 08 NËNTOR 2024

Vendi: Njësia Administrative Ruzhdie

Ora e fillimit: 10:00

Ora e mbarimit: 12:00

Dëgjuesë publike me temë: “Prezantimi i buxhetit përfundimtar për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”.

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 dhe 52 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 80, datë 18.12.2023 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2025”.

Pjesëmarrës: Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Drejtore e Financës znj. Mimoza Shtembari, Drejtor i të Ardhurave Vendore z. Çajup Refitaj, Drejtore e Urbanistikës znj. Boreta Murati, Drejtore e Projekteve znj. Ermenita Mici, përfaqësues të fshatrave, *rreth 11 pjesëmarrës (banorë dhe kryetarë të fshatrave).*

Takimin hapet nga sekretarja e Këshillit znj. Rafaela Xeba

Sekretarja e Këshillit znj. Rafaela Xeba - përshëndetje! Ju falenderoj që jeni bërë pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 dhe 52 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 80, datë 18.12.2023 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2025”, sot do të prezantojmë buxhetin përfundimtar të vitit 2025 dhe PBA-së 2025-2027. Po ia lë fjalën ekzekutivit për prezantimin e materialit.



**Sekretarja e Këshillit
znj. Rafaela Xeba**

**Dëgjese publike me temë:
Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

Nëntor 2024

Drejtoresha e financës znj. Mimoza Shtëmbari– përshëndetje të gjithëve! Ne sot do të bëjmë prezantimin e dokumentit përfundimtar të buxhetit për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-



**Drejtoresha e financës
znj. Mimoza Shtëmbari**

**Dëgjese publike me temë:
Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

Nëntor 2024

2027. Unë dëshiroj të prezantoj të ardhurat që do të përfshijë buxheti i ardhshëm, të cilat ndahen në tre kategori kryesore. Përpara se të arrinim në këtë përfundim ne kemi realizuar disa dëgjesa publike për marrjen e prioriteteve kryesore lidhur me hartimin e buxhetit dhe kemi arritur në dokumentin final që do të prezantohet sot. Ju keni qenë pjesë e ndërhyrjeve dhe punëve që janë bërë në këtë njësi administrative. Janë bërë ndërhyrjet e rrugëve bujqësore, kemi filluar me ndërhyrjet në pjesën e ndriçimit,

Drejtoresha e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban znj. Boreta Murati- lidhur me pjesën e investimeve në rrjetin rrugor unë dëshiroj të prezantoj ndërhyrjet që janë parashikuar dhe që do të përfshijnë pjesën e njësisë administrative të Ruzhdies. Për vitin 2025 është parashikuar një ndërhyrje në rrugën “Malaj” pranë qendrës shëndetësore. Gjithashtu është parashikuar edhe rruga “Patos- lagjja Mustafa Matohiti” dhe rruga e “Ofiçinës”, e cila do të financohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.



**Drejtoresha e Planifikimit dhe Zhvillimit
Urban
znj. Boreta Murati**

**Dëgjesë publike me temë:
Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”
Nëntor 2024**

Drejtoresha e Projekteve dhe Emergjencave Civile znj. Ermenita Mici- përshëndetje të gjithëve! Për sa i përket pjesës së banesave për familjet në nevojë ne do të aplikojmë për rikonstriksion e banesave të këtyre familjeve. Ky aplikim do të bëhet duke kërkuar shtrirjen e projektit në të gjithë territorin e bashkisë Patos. Gjithashtu është ndërhyrë në disa rrugë




**Drejtoresha e Projekteve dhe
Emergjencave Civile
znj. Ermenita Mici**

**Dëgjesë publike me temë:
Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”
Nëntor 2024**

kryesore siç janë rruga “Lapidari”, rruga e Ofiçinës, “Bajallarët” në Patos të vjetër dhe rruga “29 Marsi” për të ish kopshti. Një rrugë tjetër e rëndësishme që është kërkuar nga vet qytetarët është edhe rruga nga qendra e Siqecës deri në qendrën e Drenies që është bërë me rërë bituminoze.

Sekretare e Këshillit znj. Rafaela Xeba- faleminderit ekzekutivit për prezantimin e parashikimeve në buxhet. Jeni të ftuar të paraqisni pyetjet, sugjerimet apo komentet tuaja.



**Sekretare e Këshillit
znj. Rafaela Xeba**

**Dëgjesë publike me temë:
Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027"**

Nëntor 2024

Banor i njësisë Ruzhdie z. Agron Myrtaj- përhëndetje të gjithëve! Unë kam një shqetësim lidhur me rrugën të Lapidari. Ajo rrugë nuk është shtruar me rërë, bëhet fjalë për rrugën të lagjja e Shkëmbit. Duhet të ndërhyet pasi banorët nuk kanë ku të kalojnë. Të paktën të ndërhyet duket e shtruar me rërë bituminoze në mënyrë që shiu mos ta gërrycej.



**Banor i njësisë Ruzhdie
z. Agron Myrtaj**

**Dëgjesë publike me temë:
Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027"**

Nëntor 2024

Kryetar i fshatit Ruzhdie z. Sako Myftaraj- përhëndetje! Kjo rrugë të cilën e ngriti problem Agroni është diskutuar edhe më parë dhe është thënë që do riparohet. Problem tjetër



**Kryetar i fshatit Ruzhdie
z. Sako Myftaraj**

**Dëgjesë publike me temë:
Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027"**

Nëntor 2024

lidhet edhe me rrugën e Mekanit nga rruga e Shkëmbit deri te lapidari poshtë duhet shtruar me çakull.

Banor i njësisë Ruzhdie z. Agron Myrtaj- unë si qytetar kam parë që punë është bërë, por nga shkolla e lart. Unë e kam ngritur edhe më herët shqetësimin për hapjen e rrugës te toka ime në mënyrë që të shkëmbehen mjetet bujqësore. Edhe rruga që lidh lagjet nuk është bërë. Ajo rruga që fillon te spitali dhe del poshtë.



**Banor i njësisë Ruzhdie
z. Agron Myrtaj**

**Dëgjesë publike me temë:
Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027"**

Nëntor 2024

Kryetari i fshatit Siqecë z. Myftar Sorraj- faleminderit që erdhët sepse Siqeca ka shumë probleme të cilat unë dëshiroj ti paraqes në emër edhe të banorëve. E para rruga e lagjes "Xhepaj" ka shumë probleme dhe duhet rregulluar. Sistemi i ndriçimit ka problem pasi asnjë rrugë nuk ka drita duke filluar nga ambulanca e deri në të gjithë fshatin tonë. Për sa i përket ujit të pijshëm, firma që mori tenderin, lagjen "Xhepaj" që është edhe lagjia më e madhe dhe ka mbi 50 familje e kanë lënë pa ujë të pijshëm. Problemi tjetër lidhet me rrugën nga ambulanca deri te lumi që duhet karikuar dhe ka vërtet nevojë për ndërhyrje. Ajo ka nevojë për një kamion çakull.



**Kryetari i fshatit Siqecë
z. Myftar Sorraj**

**Dëgjesë publike me temë:
Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027"**

Nëntor 2024

Edhe azhornimi është problem i madh për zonën tonë. Kemi përfituar tokat me ligjin 7501 dhe akoma nuk ka kaluar azhornimi. Siqeca ka nevojë për investim dhe turizmi luan një rol shumë të rëndësishëm për fshatin. Pse të mos investohet te turizmi dhe te ujëvara e Siqecës që është një pikë turistike shumë e kërkuar. Ne na kanë ardhur turistë dhe e pëlqejnë si vend,

por nuk kemi kushtet e duhura për t'i pritur. Tjetër problem lidhet me rrugën që është në qendër të fshatit të ambulancës që është pa ndriçim. Këto janë problemet e fshatit të Siqecës. Faleminderit që më dëgjuat!

Drejtoresha e financës znj. Mimoza Shtëmbari- Ne si institucion po investojmë te pjesa e ndriçimit dhe ky problem do të mund të zhidhet shumë shpejt. Për sa i përket azhurnimit ky



**Drejtoresha e financës
znj. Mimoza Shtëmbari**

**Dëgjesë publike me temë:
Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027"**

Nëntor 2024

problem është adresuar dhe janë bërë disa takime. Mendojmë që do të ketë një risi lidhur me këtë çështje dhe besoj që do të marrim zgjidhje shumë shpejt.

Drejtoresha e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban znj. Boreta Murati- Lidhur me pjesën e ujësjellsit do e verifikojmë, por në LOT-in 3 është parashikuar që gjithë procesi të jetë i finalizuar. Gjithashtu ne do të dërgojmë një kërkesë në mënyrë që të përfundojnë i gjithë



**Drejtoresha e Planifikimit dhe Zhvillimit
Urban
znj. Boreta Murati**

**Dëgjesë publike me temë:
Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027"**

Nëntor 2024

procesi në njësinë Ruzhdië. Lidhur me problemin e rrugës "Mekani" nuk jam në dijeni, po do mundohemi ta verifikojmë dhe t'i japim zgjidhje.

Sekretarja e Këshillit znj. Rafaela Xeba- Faleminderit për pjesëmarrjen dhe për problemet e adresuara! Mirupafshim!



**Sekretarja e Këshillit
znj. Rafaela Xeba**

**Dëgjesë publike me temë:
Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

Nëntor 2024

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahina

Sekretar i Këshillit

Rafaela Xeba



